

Letërnjoftimi i Komunës së

# NOVOBËRDËS

# 2014

Maj, 2015






## Fakte

- Buxheti i Komunës së Novobërdës ka pasur rënie në vitin 2014. Kjo ka ardhur si pasojë e refuzimit të një pjese të popullatës së kësaj komune për të marr pjesë në regjistrimin e popullsisë gjatë vitit 2011.
- Komuna e Novobërdës bën pjesë në mesin e komunave të vogla për sa i takon të hyrave komunale. 98% e buxhetit të kësaj komune sigurohet nga niveli qendror, nëpërmjet granteve për komuna.
- Vlerësuar nga shkalla e të hyrave komunale, Novobërda listohet krahas komunave të formuara nga procesi i decentralizimit në vend, respektivisht krahas Ranillugut, Parteshit, Kllokotit dhe Junikut.
- Komuna e Novobërdës 75% të buxhetit e shpenzon për paga dhe mëditje, shifër kjo shumë e lartë për një komunë të vogël.
- Komuna e Novobërdës ka gjithsejtë 340 persona të punësuar, ku përfshihen 73 në administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.
- Novobërda ka të punësuar një shërbyes civil për 95 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 226 persona, prej tyre 194 janë mësimitdhënës. Në Komunën e Novobërdës raporti nxënës/mësimitdhënës është 22.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 44 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Novobërdës është 168.9. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Gjatë vitit 2014 në Komunën e Novobërdës janë regjistruar 29 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Krahasuar me vitet paraprake vërehet trend në rënie i regjistrimit të bizneseve të reja. Trend pozitiv ka shënuar hapja e bizneseve të reja bujqësore.
- Kryetari i Komunës Svetislav Ivanoviq ka dhënë 6 premtime gjatë fushatës zgjedhore. Deri në muajin maj 2015 ka përmbushur 16% të premtimeve. Përmbushja e premtimeve nga gjitha komunat deri në këtë kohë është 24%.

# 1 Qeverisja komunale


Novobërda deri në zgjedhjet e fundit (2013) është udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Pas këtyre zgjedhjeve fitues ka dal blloku i partive të minoritetit serb 'Lista Serbe' (GS). Ish kryetari i Novobërdës Bajrush Ymeri ka humbur garën ndaj kandidatit Svetislav Ivanoviq. Ky i fundit në raundin e parë ka marr 27% të votave kundrejt Ymerit i cili ka siguruar 32%. Në balotazh Ymeri ka siguruar 43% të votave, ndërsa Ivanoviq 57%.

Grafikoni nr. 1 Numri i votave në raundin e parë ndërmjet Bajrush Ymerit dhe Svetislav Ivanoviq



Pas zgjedhjeve, Kryetari i Komunës Svetislav Ivanoviq ka arritur koalicion të gjerë me pesë parti të minoritetit serb, gjegjësisht ka siguruar votat e nëntë asamblastëve, nga 15 sa janë gjithsejtë në Kuvendin komunal të Novobërdës. Kuvendi i Novobërdës përbehet nga 8 parti të ndryshme, 5 prej të cilave janë parti lokale (që funksionojnë vetëm në Novobërdë).


Grafikoni nr. 2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Novobërdës sipas zgjedhjeve të 2013



## 2 Buxheti i Komunës së Novobërdës


Buxheti i Komunës së Novobërdës ka pasur rënie në vitin 2014. Kjo ka ardhur si pasojë e refuzimit të një pjese të popullatës asaj të asaj komune për të marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë gjatë vitit 2011. Novobërda ka dalë t'i ketë nga regjistrimi i popullsisë 6,729 banorë, përderisa zyrtarët komunal në Novobërdë aludojnë që në këtë komunë jetojnë mbi 13 mijë banorë. Ministria e Financave e Qeverisë së Kosovës nga viti 2014 ka nisur të zbatojë formulën e ndarjes së granteve për komuna në bazë të numrit të popullsisë të dalë nga regjistrimi i vitit 2011.

Grafikoni nr.3 Buxheti total i Komunës së Novobërdës dhe ndarjes sipas kategorive




Komuna e Novobërdës bënë pjesë në mesin e komunave të vogla për sa i takon të hyrave komunale. 98% e buxhetit të kësaj komune sigurohet nga niveli qendror, nëpërmjet granteve për komuna. Gjatë vitit 2014 të hyrat totale të kësaj komune kanë qenë 166 mijë euro, 16 mijë euro më shumë krahasuar me një vit më herët.

Grafikoni nr.4 Të hyrat vetaneke të Novobërdës nga vitit 2011-2014




Komuna e Novobërdës pjesën më të madhe të hyrave e siguron nga tatimi në pronë (35%), nga regjistrimi i pronave (14%) dhe kategoria e tret me e madhe e të hyrave në Novobërdë është ajo e shqiptimit të gjobave në trafik nga policia (13%).

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore në Novobërdës për vitin 2014




Vlerësuar nga shkalla e të hyrave komunale, Novobërda listohet krahas komunave të formuara nga procesi i decentralizimit në vend, respektivisht krahas Ranillugut, Parteshit, Klllokotit dhe Junikut.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave nga vështrimi i të hyrave vetanake për vitin 2014



Komuna e Novobërdës 75% të buxhetit total e shpenzon për paga dhe mëditje, shifër kjo shumë e lartë për një komunë të vogël.


Grafikoni nr.7 Kategoritë e shpenzimeve buxhetore të Novobërdës për vitin 2014



### 3 Të punësuarit në sektorin publik


Komuna e Novobërdës ka gjithsejtë 340 persona të punësuar, ku përfshihen 73 në administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor.

Grafikoni nr.8 Të punësuarit në sektorin publik në Komunën e Novobërdës



Novobërda ka të punësuar një shërbyes civil për 95 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.9 Raporti i të punësuarve në administratë për kokë banori






Në sektorin e arsimit janë të punësuar 226 persona, prej tyre 194 janë mësimdhënës. Në Komunën e Novobërdës raporti nxënës/mësimdhënës është 22.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.10 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Novobërdës


### Raporti Nxënës/Mësimdhënës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 44 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Novobërdës është 168.9. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.

Grafikoni nr.11 Të punësuarit në shëndetësi sipas numrit dhe llogaritjes për kokë banori nëpër


### Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 4 Ekonomia lokale


Gjatë vitit 2014 në Komunën e Novobërdës janë regjistruar 29 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Krahasuar me vitet paraprake vërehet trend në rënie i regjistrimit të bizneseve të reja. Trend pozitiv ka shënuar hapja e bizneseve të reja bujqësore.

Grafikoni nr.12 Trendi i hapjes së bizneseve në Komunën e Novobërdës 2011-2014 sipas llojit



Në të njëjtën periudhë, në Novobërdë janë është shuar vetëm 1 biznes. Trendi i shuarjes së bizneseve ka ardhur duke renë në Novobërdë, në 2012 janë shuar 7 biznese, 3 në 2013.

Grafikoni nr.13 Shuarja e bizneseve në Novobërdë në total dhe sipas llojit 2011-2014



## 5 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Svetislav Ivanoviq gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 6 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z.Ivanoviq ka arritur të realizoj 16% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.14 Numri i premtimeve dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)